



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
**Ministria e Diasporës - Ministarstvo za Dijasporu - Ministry of Diaspora**

<b>REFERENCË:</b>	
<b>Date/Date/Datum</b>	10.04.2015
<b>PËR/ZA/TO:</b>	<b>Avdullah Hoti, Ministër i Financave</b> <b>Hasan Isufaj, u.d. drejtor i departamentit të buxhetit,</b> <b>MF</b>
<b>CC:</b>	
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>	<b>Valon Murati, Ministër i Diasporës</b> <b>Mentor Borovci, u.d. Sekretar i Përgjithshëm</b>
<b>NGA/OD/FROM:</b>	<b>Hamdi Bërbatovci, udhëheqës i Divizionit të Buxhetit</b> <b>dhe Financave</b>
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	<b>Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2016 - 2018</b>

Të nderuar,

Ministria e Diasporës ka punuar në procesin e hartimit të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) për vitin 2016-2018 dhe i ka vlerësuar kufijtë e saj për këtë periudhë, andaj po jua përcjellim këto vlerësime si më poshtë.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Diasporës - Ministarstvo za Dijasporu - Ministry of Diaspora

---

**KORNIZA AFATMESME E SHPENZIMEVE**

**2016 - 2018**

**Prill 2015**

**Prishtinë**

## **Misioni**

Ministria e Diasporës (këtu e tutje MeD) e themeluar në vitin 2011, në mandatin e saj ka të paraparë, zhvillimin dhe kultivimin e lidhjeve të institucioneve të Republikës së Kosovës dhe pjesëtarëve të diasporës tanë, shoqatat dhe format e tjera të organizimit të bashkatdhetarëve tanë.

Misioni dhe objektivat kryesore të MeD, përfshijnë, mirëpo nuk janë të limituara në, ruajtjen dhe kultivimin e identitetit kombëtar, kulturor dhe gjuhësor, ofrimi i ndihmës dhe inicimi i aktiviteteve që ndikojnë në integrimin sa më të madh socio politik të diasporës tanë në shtetet e tyre ku jetojnë dhe veprojnë, promovimi dhe avancimi i të drejtave të diasporës në vendet pritëse si dhe ndikimi i diasporës në zhvillimin ekonomik të vendit të tyre.

Të gjitha këto bëhen përmes aktiviteteve të ndryshme të parapara sipas Planit të Veprimit e janë në shërbim të përmbushjes së misionit dhe objektivave të potencuara më lartë.

## **Situata aktuale**

Marrë parasysh numrin e madh të diasporës tonë, sipas analizave të Bankës Qendrore të Kosovës, llogaritet se në vitin 2014 remitencat vjetore nga diaspora dhe mërgata ishin rreth 630 milionë euro.

Qeveria e Republikës së Kosovës, me vendimin nr. 03/145 të datës 26.8.2013, e ka aprovuar Strategjinë dhe Planin e Veprimit për Diasporën dhe Mërgatën 2013 - 2018. Strategjia për Diasporën dhe Mërgatën është dokumenti i parë strategjik i Qeverisë së Kosovës, nëpërmjet të cilit, me veprime konkrete, synohet të sigurohen avancimi i të drejtave politike e sociale të diasporës, ruajtja e identitetit kulturor e gjuhësor të diasporës, parandalimi i asimilimit, ndihma për integrimin në vendet ku jetojnë dhe lehtësi maksimale ligjore e administrative për ata që duan ta ndihmojnë zhvillimin ekonomik të atdheut të tyre.

Mbështetur në dispozitat ligjore, në Ligjin e Diasporës dhe Mërgatës, si dhe në Planin Zhvillimor Strategjik, Ministria e Diasporës e Republikës së Kosovës gjatë vitit 2014 është angazhuar për realizimin e objektivave të saj.

Hyrja në fuqi e Ligjit nr. 04/L-095 të Diasporës dhe Mërgatës, si dhe nxjerrja e akteve të tjera nënligjore kanë bërë që Ministria e Diasporës të përqendrohet në prioritetet e saj, duke hartuar dhe duke zbatuar politikat e veta në promovimin, ruajtjen dhe kultivimin e identitetit kulturor, gjuhësor dhe arsimor të pjesëtarëve të diasporës.

Këtë vit janë bërë hapa konkretë për krijimin e urave lidhëse mes pjesëtarëve të diasporës dhe institucioneve të Republikës së Kosovës, por edhe për krijimin dhe forcimin e lidhjeve brenda vetë diasporës.

## Aktivitetet

- Krijimi dhe funksionalizimi i Rrjetit të Studentëve dhe të Rinjëve në Diasporë, si dhe kanë përfunduar të gjitha përgatitjet për fillimin e projektit të Rrjetit të Juristëve në Diasporë. Në kohën e raportimit, këto projekte janë duke u implementuar sipas dinamikës së paraparë.
- Qendra Kulturore e Kosovës për Diasporën dhe Mërgatën (QKKDM) në Turqi si qendër e parë është hapur më 23.02.2013, ndërsa me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 25.10.2013 është paraparë të themelohen edhe qendra të tilla në Zvicër, Gjermani, Francë, Austri, Suedi dhe SHBA. Krahas QKKDM-ve në Turqi dhe Zvicër në mars të vitit 2014 është hapur QKKDM në Suedi.
- Memorandumi për hapjen dhe funksionalizimin e Qendrave të përbashkëta Kulturore mes Republikës së Kosovës dhe Shqipërisë është nënshkruar në mbledhjen e përbashkët të dy qeverive më 23 mars 2015.
- Gjithashtu, Qeveria më 29.11.2013 e ka aprovuar Rregulloren nr. 32/2013 për hartimin e Regjistrimit të Mërgimtarëve, shoqatave dhe formave të tjera të organizimit të tyre. MeD-ja është në pjesën më të rëndësishme të procesit të hartimit të regjistrimit të diasporës dhe mërgatës, dhe për këtë arsye grupi punues i përbërë nga ekspertë të fushave të ndryshme kanë përpiluar një raport me rekomandime për Ministrin të cilat janë aprovuar dhe janë në fazën fillestare të implementimit.
- Marrëveshja për organizimin e përbashkët të mësimit të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë dhe mërgatë po ashtu është nënshkruar gjatë mbledhjes së dy qeverive në Tiranë mes MeD-së dhe MASHT-it në Kosovë, si dhe MAS-it në Shqipëri. Pritet themelimi i grupeve punues për fillimin e implementimit të këtij projekti.
- Ministria e Diasporës i ka pajisur me literaturë të nevojshme shkollat me mësim plotësues dhe bibliotekat në të gjitha vendet ku jeton dhe vepron mërgata jonë. Ministria e Diasporës, në bashkëpunim me komunat e Republikës së Kosovës dhe institucionet e tjera qeveritare dhe joqeveritare, i ka organizuar “Ditët e Diasporës”, manifestim ky që ka për qëllim t’u ofrojë bashkatdhetarëve tanë mundësi për t’u njohur më shumë me artin, kulturën dhe arsimin shqip.
- Ndër prioritetet e Ministrisë së Diasporës është tërheqja e investimeve nga diaspora në Kosovë. Në këtë kuadër janë organizuar një numër i madh i konferencave, të cilat kanë pasur për qëllim t’i sensibilizojnë dhe t’i informojnë bashkatdhetarët tanë për mundësitë që Kosova u ofron për të investuar, si dhe për benefitet që do t’u sillte ky investim. Po

ashtu, është funksionalizuar Rrjeti i Grave në Biznes, si dhe është vazhduar me procesin e Rrjetëzimit të Bizneseve të Diasporës.

## Objektivat

1. Promovimin dhe avancimin e të drejtave politike dhe sociale të diasporës
2. Ruajtjen dhe identitetin dhe fuqizimin e lidhjeve me diasporës
3. Mbështetjen për integrimin e diasporës në vendet pritëse dhe
4. Përfshirjen e diasporës në zhvillimin socio-ekonomik

Objekti i parë, "Promovimi dhe avancimi I të drejtave politike dhe sociale të diasporë" ka për synim të përmirësojë pozitën e pjesëtarëve të diasporës dhe mërgatës përmes fuqizimit të pjesëmarrjes së tyre në proceset politike dhe sociale në Kosovë. Kjo objektivë synohet të arrihet përmes këtyre aktiviteteve:

- Themelimi i Komisionit parlamentar për diasporën
- Krijimit të Kuvendit të Përgjithshëm të Diasporës dhe Mërgatës, me delegatë nga Kuvendet e Diasporës në shtetet përkatëse ku ajo jeton dhe vepron
- Sigurimi I pjesëmarrjes aktive të diasporës në proceset e vendimmarrjes dhe politik-bërjes në Kosovë, përmes dëgjimeve publike dhe aktiviteteve të ngjashme
- Regjistrimit të pjesëtarëve të diasporës dhe mërgatës si dhe të formave të ndryshme të organizimit të tyre
- Krijimin e lehtësirave në qasjen e shërbimeve administrative për pjesëtarët e diasporës, në Republikën e Kosovës

Objekti i dytë, "Ruajtja e identitetit dhe fuqizimi I lidhjeve me diasporën", ka për synim përfshirjen e një numri sa më të madh të nxënësve me prejardhje nga Kosova dhe trojet tjera shqiptare në procesin e mësimin plotësues të gjuhës dhe kulturës shqiptare në vendet ku ata jetojnë. Kjo objektivë synohet të arrihet përmes sensibilizimit të mërgimtarëve për rëndësinë e mësimin plotësues në ruajtjen e identitetit gjuhësor dhe kulturor, duke përfshirë aktivitetet si në vijim:

- Implementimin e marrëveshjes së nënshkruar mes MeD, MASHT dhe MAS të Shqipërisë
- Sigurimi i librave dhe i mjeteve të tjera mësimore, organizimi i shkollave verore dhe dimërore, organizimi i kuizeve të diturisë, organizimi i ekskursioneve mësimore në atdhe, botimi i revistave dhe publikimeve të tjera për fëmijë, organizimi i trajnimeve dhe seminareve për mësuesit e mësimin plotësues si dhe ofrimi i mundësive për studim në universitetet publike të Kosovës, për studentët të cilët vijnë nga diaspora.
- Mbështetjen dhe nxitjen e aktiviteteve kulturore, letrare, artistike e të ngjashme në funksion të ruajtjes, kultivimit dhe promovimit të kulturës dhe traditës së vendit të origjinës së pjesëtarëve të diasporës.
- Grumbullimin e eksponateve dhe dokumenteve me vlerë muzeore e arkivore të pjesëtarëve të diasporës

- Zbatimi i memorandumit të bashkëpunimit ndërmjet MeD, MKRS dhe MK të Republikës së Shqipërisë me nënshkrimin dhe zbatimin e marrëveshjes për programin “Ditët e kulturës shqiptare në diasporë”

Objektivi i tretë, “Mbështetja për integrimin e diasporës në vendet pritëse”, ka për qëllim mbështetjen institucionale për integrimin e pjesëtarëve të diasporës në vendet ku ata jetojnë dhe veprojnë. Kjo synohet të arrihet përmes organizimit të diasporës në aktivitete si:

- Themelimi dhe funksionalizimi i Qendrave Kulturore
- Mbështetjen dhe organizimin e pjesëtarëve të diasporës në forma të ndryshme organizative dhe bashkëpunimi i tyre përmes rrjetëzimit
- Informimi i pjesëtarëve të diasporës për të drejtat dhe obligimet e tyre në vendet ku ata jetojnë dhe veprojnë, përmes rrjeteve.
- Promovimi i shembujve të suksesit të pjesëtarëve të diasporës.
- Zbatimi i memorandumit të bashkëpunimit në mes të MeD, MKRS dhe MK e Republikës së Shqipërisë me nënshkrimin dhe zbatimin e marrëveshjes për themelimin e Qendrave të përbashkëta Kulturore

Objektiva e katërt “Përfshirja e diasporës në zhvillimin socio-ekonomik”, ka për synim fuqizimin e bashkëpunimit të diasporës me Republikën e Kosovës, për zhvillimin ekonomik të Kosovës, stimulimin dhe krijimin e lehtësimeve për tërheqjen e investimeve nga diaspora dhe promovimin e kthimit të potencialit intelektual të diasporës. Kjo synohet të arrihet përmes aktiviteteve në vijim:

- Organizimin e konferencave, forumeve, panairove dhe organizimeve të ngjashme për promovimin e investimeve të diasporës në Kosovë.
- Funksionalizimin e rrjeteve të bizneseve të diasporës
- Inkurajimin e diasporës për pjesëmarrje në projektet e partneritetit publiko-privat.
- Përfshirja e bizneseve nga diaspora në zonat ekonomike, parqet e biznesit, parqet teknologjike dhe inkubatorët e biznesit;
- Identifikimi dhe angazhimi i profesionisteve të profileve të ndryshme që të angazhohen në programet e ndryshme zhvillimore.
- Krijimi i një programi për kthimin e potencialit intelektual në Kosovë

1. Historiku dhe shpenzimet e politikave bazë për 2015-2017

Ministria e Diasporës	Viti 2014 aktual	Viti 2015 Buxheti 2015	2016 Vlerësuar	2017 Vlerësuar	2018 Vlerësuar
<b>Total</b>	<b>1,780,304.00</b>	<b>1,856,628.00</b>	<b>1,697,448.00</b>	<b>1,697,448.00</b>	<b>1,697,448.00</b>
Nr. I punëtorëve	66	66	66	66	66
Paga dhe Mëditje	397,123.00	473,889.00	473,889.00	473,889.00	473,889.00
Mallra dhe Shërbime	1,231,282.00	1,227,239.00	1,068,059.00	1,068,059.00	1,068,059.00
Shpenzimet Komunale	8,825.00	25,500.00	25,500.00	25,500.00	25,500.00
Subvencionet dhe Transferet	143,074.00	130,000.00	130,000.00	130,000.00	130,000.00
Shpenzimet Kapitale	-	-	-	-	-
<b>Burimet e Financimit</b>	-	-	-	-	-
Grandet Qeveritare	-				
Të hyrat Vetanake	-				
Financimet nga Huamarrjet	-				
Grandet dhe donatorët	-				

Përveç kufijve aktual buxhetor, MeD gjithashtu parashtron kërkesa shtesë për projektet të cilat janë të parapara sipas Strategjisë 2013-2018 dhe PVP-së, e janë identifikuar si të nevojshme për diasporën tonë. Disa nga këto projekte (ju lutem shihni bashkangjitur) paraqesin edhe obligime ndërshtetërore të cilat janë rrjedhojë e nënshkrimit të marrëveshjeve bilaterale.

<b>Kërkesat Shtesë</b>			
<b>Ministria e Diasporës</b>	<b>2016 Vlerësuar</b>	<b>2017 Vlerësuar</b>	<b>2018 Vlerësuar</b>
<b>Total</b>	<b>2,896,400.00</b>	<b>2,896,400.00</b>	<b>2,896,400.00</b>
Nr. I punëtorëve	13	13	13
Paga dhe Mëditje	1,276,400.00	1,276,400.00	1,276,400.00
Mallra dhe Shërbime	1,420,000.00	1,420,000.00	1,420,000.00
Shpenzimet Komunale	-	-	-
Subvencionet dhe Transferet	200,000.00	200,000.00	200,000.00
Shpenzimet Kapitale	-	-	-
<b>Burimet e Financimit</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
Grandet Qeveritare			
Të hyrat Vetanake			
Financimet nga Huamarrjet			
Grandet dhe donatorët			

### **Orientimi i remitancave për investime në bujqësi**

Duke u bazuar programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës 2015-2018, përkatësisht pikës 1.4.2 që trajton lehtësimin dhe promovimin e investimeve nga diaspora, e ku theksohet se “duhet të rritet pjesa e remitancave që do të dedikohet për investime, në mënyrë që të gjenerohen vende pune dhe zhvillim ekonomik”, Ministria e Diasporës propozon që nga viti i ardhshëm, fillimisht si një pilot projekt të fillojë zbatimin projekti “Orientimi i remitancave për investime në bujqësi”.

Ky projekt do të stimulonte që diaspora jonë në vend të remitancave për familjet e veta, të ndihmojë ato duke u bërë vetë pjesë e projekteve biznesore në bujqësi të cilat do të bashkë-financoheshin nga ata vetë, Qeveria e Kosovës si dhe donatorët. Me këtë rast do të rriteshin vendet e punës, do të ndikohej në zhvillimin ekonomik si dhe do të angazhohej potenciali i diasporës në zhvillimin socio-ekonomik të vendit.

Projekti do të përmbante jo vetëm bashkëfinancimin e projekteve nga diaspora, por edhe shfrytëzimin e potencialeve profesionale dhe intelektuale të diasporës sonë në fazën e përgatitjeve të projekteve dhe të trajnimeve të fituesve të granteve. Në këtë mënyrë do të realizonim edhe një objektiv tjetër programor që është shfrytëzimi i kapitalit njerëzor të diasporës sonë në zhvillimin e vendit.

Projekti parashihet të realizohet në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë si dhe me donatorët e huaj të cilët kanë shprehur deri më tani një pëlqyeshmëri për këtë projekt.



Në vitin e parë, në të cilin projekti do të realizohet si një pilot projekt, parashihet që buxheti i projektit të jetë 1.000.000 euro. Kostoja buxhetore për Ministrinë e Diasporës do të jetë 200.000 euro për vit.

Kjo kosto për Ministrinë e Diasporës llogaritet të mbetet e njëjtë edhe në 3 vitet e ardhshme kur do të rritet buxheti për vetë projektin. Rritja e buxhetit të projektit do të realizohet me përfshirjen më të madhe të donatorëve në të.

### **Themelimi i Qendrave Kulturore të Kosovës për Diasporën dhe Mërgatën**

Qeveria e Kosovës, me datë 25.10.2013, ka marrë vendimin nr. 05/153 për themelimin e Qendrave Kulturore të Kosovës për Diasporën dhe Mërgatën në këto shtete: Zvicër, Gjermani, Francë, Austri, Suedi dhe SHBA, si dhe me datë 30.01.2013 ka marrë vendimin me nr. 08/2014 për hapjen e qendrës Kulturore të Kosovës për Diasporën dhe Mërgatën në Turqi, të cilat funksionojnë në bazë të ligjit 04/L-095 për diasporën dhe mërgatën. Qendrat në Zvicër, Turqi dhe Suedi tashmë janë hapur. Gjatë periudhës 2016-2018 Ministria e Diasporës ka për detyrë të udhëheqë të gjitha procedurat për themelimin dhe funksionalizimin e Qendrave në Gjermani, Francë, Austri dhe SHBA.

Gjithashtu gjatë mbledhjes së përbashkët të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të datës 23 mars 2015 në Tiranë, ndër të tjera është nënshkruar edhe Memorandumi i Bashkëpunimit në mes të Ministrisë së Diasporës, Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe Ministrisë së Kulturës së Republikës së Shqipërisë, për realizimin e aktiviteteve të përbashkëta kulturore në diasporë si dhe hapjen e Qendrave të përbashkëta kulturore në Diasporë.

Gjatë kësaj kohe do të duhet të komunikohet dhe negociohet marrëveshja me Ministrinë e Kulturës së Shqipërisë dhe dakordimin për fillimin e një pilot qendre të përbashkët gjatë vitit 2016 si dhe akordimin për hapjen e qendrave të reja dhe bashkëpunimin në qendrat aktuale në Turqi, Zvicër dhe Suedi, por edhe në vendet tjera të përcaktuara me vendimin e Qeverisë nr 05/153.

Për hapjen e këtyre qendrave do të duhet të gjendet lokacioni, infrastruktura ligjore dhe teknike e punës së qendrave si dhe plotësimi me staf. Të gjitha këto aktivitete do të ndërmirën gjatë këtyre tre viteve dhe do të funksionohet edhe në bazë të rekomandimeve të komisionit për ri konceptimin e Qendrave Kulturore i cili përbëhet nga British Council, Aliance Françias, Forumi Kulturor, Qendra Kulturore Turke si dhe Ministrinë e linjës

Kosto financiare për hapjen dhe funksionalizimin e këtyre qendrave dhe realizimin e vendimit dhe objektivit nga Ministria e Diasporës është 500.000 Euro për një vit.

## **Realizimi I marrëveshjes për mësimin plotësues të gjuhës dhe kulturës shqipe**

Gjatë mbledhjes së përbashkët të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të datës 23 mars 2015 në Tiranë, ndër të tjera është nënshkruar edhe marrëveshja e bashkëpunimit në mes të MeD, MASHT dhe MASRSH (në vazhdim "palët").

Qëllimi i kësaj marrëveshje është angazhimi dhe interesi i përbashkët për mbështetjen e mërgates në ruajtjen, zhvillimin dhe promovimin e identitetit kulturor, gjuhësor dhe arsimor me anë të organizmit të mësimin të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në mërgate.

Organizimi i përbashkët i mësimin të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në mërgate realizohet me anë të:

1. Harmozimit të legjislacioneve përkatëse.
2. Hartimit të korrikulave dhe të teksteve mësimore të unifikuara.
3. Përcaktimit të standardeve të përbashkëta të rekrutimit të mësuesve.
4. Bashkëfinancimit të projekteve dhe të programeve, të miratuara nga institucionet përgjegjëse të palëve.
5. Organizimit të përbashkët të fushave sensibilizuese dhe promovimit të aktiviteteve të përbashkëta.

Aktivitetet që dalin nga marrëveshja

- Korrikula e përbashkët
- Kulafikimi i mësimeve
- Procedura e rekrutimit
- Financimi
- Nisma dhe lidhja e marrëveshjeve me shtetet e treta
- Organizimi i fushave sensibilizuese
- Krijimi i grupeve punuese të përbashkëta për të përcaktuar dinamikën e zbatimit të detyrave nga kjo Marrëveshje.

Kostoja e kësaj marrëveshje sipas projeksioneve të palëve do të jetë 3,000,000 euro për vit, e që do të ndahet proporcionalisht nga 1,500,000 euro prej secilës palë. Në këtë rast kjo shumë do të administrohet nga MeD dhe/apo MASHT.

Politika e re prioritare 1: Ruajtja e identitetit dhe fuqizimi i lidhjeve me diasporën.	2016	2017	2018
	Plan	plan	plan
<b>Shpenzimet sipas nënprogramit ose aktivitetit</b>			
<b>Totali</b>	<b>1,500,000.00</b>	<b>1,500,000.00</b>	<b>1,500,000.00</b>
Zbatimi i marrvveshjes pwr organizimin e përbashkët tw gjuhws shqipe dhe kulturws shqiptare në diasporë dhe mërgatë	1,500,000.00	1,500,000.00	1,500,000.00
<b>Shpenzimet sipas kategorisë ekonomike</b>			
<b>Totali</b>	<b>1,500,000.00</b>	<b>1,500,000.00</b>	<b>1,500,000.00</b>
Paga dhe mëditje	1,100,000.00	1,100,000.00	1,100,000.00
Mallra dhe shërbime	400,000.00	400,000.00	400,000.00
Shpenzime komunale	-	-	-
Shpenzime kapitale	-	-	-
<b>Financimi i propozuar</b>			
<b>Financimi i propozuar total</b>	<b>1,500,000.00</b>	<b>1,500,000.00</b>	<b>1,500,000.00</b>
Grantet qeveritare	1,500,000.00	1,500,000.00	1,500,000.00
Të hyrat vetjake / 1			
<b>Indikatorët kyç, shtytësit e kostos dhe parametrat</b>			
Rritja e numrit të nxënësve në shkollat ekzistuese			
Rritja e numrit të nxënësve në shkollat e reja			
Kualifikimi i stafit ekzistues të mësuesve			
Përtëritja e kuadrit mësimor			

### “Ditët e kulturës shqiptare”

Gjatë mbledhjes së përbashkët të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të datës 23 mars 2015 në Tiranë, ndër të tjera është nënshkruar edhe memorandumi i bashkëpunimit në mes të ministrisë së Diasporës, Ministrisë së kulturës Rinisë dhe Sportit dhe Ministrisë së Kulturës së Republikës së Shqipërisë, për realizimin e aktiviteteve të përbashkëta kulturore në diasporë si dhe hapjen e Qendrave të përbashkëta kulturore në Diasporë.

Derivat i këtij memorandumi është edhe aktiviteti i dakorduar “Ditët e kulturës shqiptare në diasporë” në qytete të ndryshme të botë ku është e koncentruar diaspora jonë.

Ministria e Diasporës në kuadër të projekteve të saj tradicionale, përkrah dhe organizon aktivitete kulturore me dhe për diasporën. Gjithashtu edhe ministritë e Kulturës së Kosovës dhe

Shqipërisë kanë disa programe që lidhen me diplomacinë kulturore. Njëkohësisht edhe Ministrinë e Punëve të Jashtme të dy vendeve kanë programe të ngjashme për diplomaci publike. Me qëllim të bashkërendimit të aktiviteteve është dakorduar të organizohet ky aktivitet, në qendrat kryesore të botës.

Meqenëse Ministria e Diasporës do të ketë rolin koordinues edhe mes Ministrive partnere në program por edhe shoqatave dhe artistëve nga diaspora, do të ketë edhe kosto financiare.

Parashihet që kostoja e këtyre aktiviteteve për vit të jetë rreth 600,000.00 Euro, të cilat do të mbulohen nga ministrinë e linjës, bizneset shqiptare në diasporë, donatorët dhe kontribuuesit tjerë.

Aktivitetet:

- Koordinimi i aktiviteteve në mes të gjitha palëve të angazhuara
- Kontaktimi dhe krijimi i marrëdhënieve me palë të treta, donator, artist
- Konceptimi i aktiviteteve
- Koordinimi dhe bashkëpunimi me shoqatat kulturore në diasporë
- Hulumtimi i lokacioneve dhe krijimi i marrëveshjeve të shfrytëzimit
- Promovimi i aktiviteteve përmes fushatës mediale

Gjatë këtij aktiviteti do të përfshihen prezantime nga këto fusha:

- Teatër
- Kinematografi shqiptare
- Muzikë
- Valle dhe këngë popullore
- Arte pamore
- Shfaqje në hapësira
- Debate me artistë shqiptarë nga diaspora dhe trojet shqiptare;
- Letërsi shqiptare
- Prezantim i trashëgimisë kulturore
- Prezantim i turizmit shqiptar (dimëror dhe veror)
- Promovim i mundësive për investime

Kostoja e shpenzimeve nga Ministria e Diasporës për këtë projekt/për vit është 120.000 Euro.

## **PROJEKTI I REGJISTRIT**

Procesi i hartimit të regjistrit të diasporës dhe mërgatës, ka hasë në ngecje gjatë implementimit të paraparë sipas dinamikës së punës në PVP 2014.

Për këtë arsye, MeD nuk ka shpenzuar buxhetin prej 1.2 milionë eur gjatë vitit 2014.

Grupi punues për rishikimin dhe vlerësimin e procesit të regjistrit të diasporës dhe mërgatës, ka rekomanduar që procesi i regjistrit të diasporës dhe mërgatës të vazhdohet deri në vitin 2018, duke shfrytëzuar buxhetin prej 1.2 milionë euro.

<b>Rekapitulum:</b>			
<b>Ministria e Diasporës</b>	<b>2016 Vlerësuar</b>	<b>2017 Vlerësuar</b>	<b>2018 Vlerësuar</b>
<b>Total</b>	<b>4,593,848.00</b>	<b>4,593,848.00</b>	<b>4,593,848.00</b>
Nr. I punëtorëve	79.00	79.00	79.00
Paga dhe Mëditje	1,750,289.00	1,750,289.00	1,750,289.00
Mallra dhe Shërbime	2,488,059.00	2,488,059.00	2,488,059.00
Shpenzimet Komunale	25,500.00	25,500.00	25,500.00
Subvencionet dhe Transferet	330,000.00	330,000.00	330,000.00
Shpenzimet Kapitale	-	-	-
<b>Burimet e Financimit</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
Grandet Qeveritare			
Të hyrat Vetanake			
Financimet nga Huamarrjet			
Grandet dhe donatorët			